

## Pyetësor

1. Çfarë janë rrezet infra të kuqe?
  - Transferimi i energjisë me anë të valëve elektromagnetike
  - Rrezatimi i çliruar nga grimca elektromagnetike
  - Njëlloj gazi
  - Një reaksion, që shkakton ngrirjen e ujit
2. Sa është brezi i gjatësisë së valës për rrezet infra të kuqe?
  - 750 nm – 1 mm
  - 1 mm-100 00 km
  - 10 nm – 390 nm
  - Më pak se 0,01 nm
3. Cilët nga trupat e mëposhtëm emeton më shumë rreze infra të kuqe?
  - Dielli
  - Një mollë
  - Një dardhë
  - Një qenie njerëzore
4. Pse janë të favorshme rrezet infra të kuqe për studimin e hapësirës, ku janë formuar re të mëdha gazi?
  - Nuk është dhe aq i favorshëm sa llojet e tjera të valëve elektromagnetike.
  - Ka gjatësi vale më të madhe se drita e dukshme, të cilat mund të kalojnë përmes këtyre reve
  - Ka gjatësi vale më të vogël se llojet e tjera të valëve të spektrit elektromagnetik, të cilat mund të kalojnë përmes këtyre reve.
  - Rrezet infra të kuqe përthithen nga këto re gazi, kështu që ne nuk mund t'i kapim këto rreze që dalin nga pas këtyre reve.
5. Si mund të kuptojmë që ka emetim rrezesh infra të kuqe, edhe pse nuk mund t'i shohim?
  - Duke i shijuar
  - Duke i nuhatur
  - Duke i dëgjuar
  - Duke i ndier
  -
6. Me çfarë shpejtësie përhapen rrezet infra të kuqe?
  - 330 m/s
  - $3 \cdot 10^8$  m/s
  - Në shpejtësi të ndryshme

- 30 m/orë
7. Çfarë gjatësie vale kanë rrezet infra të kuqe në krahasim me dritën e dukshme?
- Më të gjatë
  - Më të shkurtër
  - Kanë të njëjtën gjatësi
  - Për rrezet infra të kuqe, gjatësia e valës ndryshon dhe mund të jetë dhe më e madhe, në varësi të disa faktorëve
8. Pse trupat e errët marrin nxehtësi direkt nga rrezet e Diellit, edhe pse një pjesë e rrezeve infra të kuqe, që vijnë nga Dielli, nuk kalojnë përmes atmosferës?
- Trupat e errët janë përthithës të mirë të të gjitha llojeve të valëve elektromagnetike dhe i emetojnë më pas ato si rreze infra të kuqe.
  - Trupat e errët nuk e marrin nxehtësinë direkt nga drita e Diellit.
  - Ata përthithin gradualisht rrezet infra të kuqe që vijnë nga Dielli dhe nxehen.
  - Ata kryesisht nxehen nga Toka dhe mendimi se nxehen nga rrezet infra të kuqe është i gabuar.

Pyetjet	1	2	3	4	5	6	7	8
Përgjigjet e sakta	1	1	1	2	4	2	1	3